



BULETIN JAVOR

22-26 PRILL 2024



Shqipëria merr vendin e parë në Emiratet e Bashkuara Arabe për sigurinë kibernetike

Shqipëria zë **VENDIN E PARË** në Kompeticionin Global të Sigurisë Kibernetike GISEC, që u zhvillua nga Agjencia e Kombeve të Bashkuara ITU (Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit) dhe Këshilli i Sigurisë Kibernetike të Emirateve të Bashkuara Arabe, në Dubai.

Ky kompeticion hyri në Librin Guinness, për shkak të numrit të lartë të vendeve pjesëmarrëse, nga ku Shqipëria nxori në pah ekspertizën dhe angazhimin serioz për të adresuar kompleksitetin e sigurisë kibernetike në një botë ku zhvillimet teknologjike kanë një shpejtësi marramendëse.

Shumë krenarë për përfaqësuesit e Shqipërisë nga AKCESK dhe AKSHI: Ilir Daka, Adriano Lleshi dhe Franc Zylyftari që përfaqësuan me shumë dinjitet dhe profesionalizëm Shqipërinë përgjatë tre ditëve të aktivitetit, 23-25 prill 2024.

Eventi bëri bashkë ekspertë të sigurisë kibernetike, të apasionuar pas teknologjisë dhe institucione publike nga gjithë bota.



Përmbajtja:

- Shqipëria merr vendin e parë në Emiratet e Bashkuara Arabe për sigurinë kibernetike
- Trajnimi teknik i AKCESK për Sigurinë Kibernetike në Institutin Kanadez të Teknologjisë (CIT)
- Trajnim për Sigurinë Kibernetike në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës



Trajnimi teknik i AKCESK për Sigurinë Kibernetike në Institutin Kanadez të Teknologjisë (CIT)

AKCESK në bashkëpunim me Institutin Kanadez të Teknologjisë (CIT) organizoi një Trajnim Teknik dinamik për Sigurinë Kibernetike të mbajtur nga Z. Ergis Gaxho, Z. Gerald Bici dhe Z. Kristian Josifi, i koordinuar nga Assoc. Prof. Reis Mulita dhe Dr. Wassim Ahmad. Pjesëmarrësit fituan njohuri praktike për parandalimin e sulmeve kibernetike dhe si të qëndrojnë përpara tendencave në zhvillim të kërcënimit. Një pikë kryesore e seancës ishte përdorimi i platformës Cyber Drill, e cila ofroi një përvojë gjithëpërfshirëse simulimi kibernetik, duke i lejuar pjesëmarrësit të testonin aftësitë e tyre në një skenar realist të sulmit kibernetik.

Për të njohur angazhimin e tyre, të gjithë pjesëmarrësit morën një certifikatë pjesëmarrjeje nga AKCESK, duke theksuar përfundimin e tyre të trajnimit.



Trajnim për Sigurinë Kibernetike në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës

Në datën 26 Prill, AKCESK zhvilloi në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës një trajnim me temë: TableTOP Exercises & Cyber Drill. Siguria kibernetike është bërë kryefjalë e viteve të fundit, pas sulmeve të shumta mbi platformat e institucioneve publike që kanë paralizuar punën dhe shërbimet e shumë prej tyre.

Trajnimi synoi të informojë dhe aftësojë studentët me situata konkrete në mjedisin e sulmeve kibernetike nëpërmjet skenarëve real: Catch the Flag. Nëpërmjet Catch the Flag ofrohet një mjedis mësimi dinamik dhe praktik për të rritur dhe demonstruar aftësitë e sigurisë kibernetike. Këto aktivitete nxisin vizionin e studentëve në lidhje me të gjitha mundësitë profesionale që ofron Teknologjia e Informacionit.